

## PROCESVERBAL

Sot, më datë 29.08.2019, në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, u organizua takimi vijues me kryetarët e shoqatave të kineastëve dhe përfaqësues të mandatuar të tyre, për përzgjedhjen e aplikimeve të depozituara deri në datën 20.08.2019 për Këshillin e Miratimit të Projekteve të QKK-së. Në takim morën pjesë:

Z. Kristaq Mitro,

Z. Artan Maku,

Z. Ndriçim Xhepa,

Z. Dritan Huqi,

Znj. Sabina Kodra,

Z. Mevlan Shanaj,

Z. Pluton Vasi,

Z. Jonid Jorgji.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë përfaqësohej nga:

Z. Eduart Makri, Kryetar;

Z. Arben Lami, Drejtor i Drejtorisë së Projekteve;

Znj. Shqiponja Dauti, Juriste.

Të gjithë pjesëmarrësit diskutuan në lidhje me aplikimet për anëtarë të Këshillit të Miratimit të Projekteve të klasifikuara nga Kryetari i QKK me Vendimin nr. 453 Prot., datë 26.08.2019. Klasifikimi u bë sipas kritereve të bashkëpranuara nga palët pjesëmarrëse në takimin e datës 04.07.2019.

Përfaqësuesi i shoqatës "Lumiere", z. Mevlan SHANAJ, parashtroi opinionet e shoqatës që përfaqëson dhe më pas u largua nga mbledhja, duke mos u bërë pjesë e vendimmarrjes.

Pas diskutimeve, pjesëmarrësit në takim, të cilët përfaqësojnë shumicën e komunitetit, 7 shoqata të kineastëve, u dakordësuan sa më poshtë:

1. Kryetarët/përfaqësuesit e mandatuar të shoqatave prezente të njoftojnë dhe konsultojnë me anëtarësinë e tyre listën e aplikantëve për anëtarë të Këshillit të Miratimit të Projekteve të klasifikuara nga Kryetari i QKK me Vendimin nr. 453 Prot., datë 26.08.2019, sipas kritereve të bashkëpranuara nga palët pjesëmarrëse në takimin e datës 04.07.2019.

2. Pas miratimit nga shoqatat që përfaqësojnë, të paraqesin në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë në datën 06.09.2019 përbërjen e Këshillit të Miratimit të Projekteve, konform nenit 8, paragrafi i parë i ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë", të ndryshuar.

Pjesëmarrësit në mbledhje nënshkruan pa vërejtje procesverbalin në dy kopje origjinale.

Takimi, ashtu siç është rënë dakort paraprakisht u rregjistrua në audio.

Kristaq MITRO

Artan Maku

Ndriçim Xhepa

Dritan Huqi

Sabina Kodra

Jonid Jorgji

Pluton Vasi

Eduart Makri

Arben Lami

Shqiponja Dauti